



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

MANUALI PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI I PËRFORMANCES SE STAFIT AKADEMIK

2020, PEJË

1. Çfarë Çka nënkupton planifikimi dhe vlerësimi i përfomances se stafit akademik?

- Planifikimi nënkupton hartimin e një plani zhvillimor nga secili anëtar i stafit akademik të UHZ-së, në bazë të cilit përcaktohen objektivat e punës një vjeçare.
- Me termin “vlerësim të përfomances” nënkuptohet vlerësimi i aftësive dhe kapaciteteve të stafit akademik të UHZ-së dhe kontributi i tyre në ngritjen e cilësisë dhe zhvillimit të Universitetit.

2. Cili është qëllimi dhe rëndësia e vlerësimit të përfomances së stafit akademik të UHZ-së?

- Qëllimi është të krijojë një mekanizëm për të ndihmuar stafin e UHZ-së që të zhvillohet gjatë procesit të ndërtimit të karrierës së tyre, që të kontribuojë në cilësinë e punës si dhe të harmonizojë punën e tyre me objektivat strategjike të UHZ-së.
- Rëndësia e planifikimit dhe vlerësimit të përfomances se stafit akademik të UHZ-së është e dyfishtë:
 - Në aspektin institucional
 - Në aspektin individual.

3. Cilat janë parimet e vlerësimit?

- Vlerësimi duhet të jetë i drejtë, i ndershëm dhe në përputhje me rregullat e Kodit të Etikës së UHZ-së.
- Gjatë vlerësimit duhet të merren parasysh këto parime:
 - Parimi i drejtësisë dhe barazisë në vlerësim
 - Parimi i Konfidencialitetit.

4. Cila është periudha e vlerësimit?

Vlerësimi ndahet në dy periudha:

- a) Vlerësimi afatshkurtër
 - a) Tre –katër vjeçare (kur përfundon kontrata e punës)
- b) Vlerësimi afatgjatë
 - a) Vlerësim semestral nga studentët
 - b) Vetëvlerësimi në fund të vitit
 - c) Vlerësimi nga mbikëqyrësi në fund vitit

5. Cilët janë vlerësuesit dhe të vlerësuarit?

Procesi i vlerësimit i ka dy palë:

- Vlerësuesit (Mbikëqyrësi, Vetëvlerësimi, studenti)
- Të vlerësuarit (stafi akademik)
- Vlerësuesit duhet të kenë parasysh këto rregulla etike:

Procedurat dhe kriteret që do të përdoren për vlerësim duhet të jenë të deklaruar paraprakisht dhe secila palë e përfshirë duhet t'i ketë të qarta që në fillim të vitit akademik;

Palët e përfshira në vlerësim duhet të deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të kenë me stafin akademik të veçantë;

6. Cilat janë elementet e vlerësimit të përfomances?

1. Procesi mësimor;
2. Kërkimi dhe zhvillimi akademik;
3. shërbimeve administrative akademike;
4. shërbimeve profesionale në interes të shoqërisë.

7. Cila është pesha e vlerësimit?

1. Plani individual zhvillimor
2. Peshat dhe nivelet e vlerësimit
 - Dekani 50%
 - Vetëvlerësimi 30%
 - Studenti 20%

8. Cilat janë procedura e vlerësimit dhe përgjegjësitë institucionale?

- Raporti i vlerësimit të përfomances duhet të përmbushet nga mbikëqyrësi.
- Raportet e vlerësimit duhet të plotësohen në mënyrë elektronike.
- ZZHAPA është përgjegjës për realizimin e këtij procesi dhe ZSC
- Në nivel të njësive akademike përgjegjëse për realizimin e këtij procesi janë Koordinatorët e Cilësisë në bashkëpunim me komisionet e studimeve për pyetësorët e vlerësimit të stafi akademik nga studentët dhe vetëvlerësimin.

Teksti i Manualit për Planifikim dhe Vlerësim të Përfomances së stafit akademik mund të shkarkohet nga linkun në vijim:

Versioni Shqip: https://drive.google.com/file/d/1_L8GqGmCRtDBRtWuy690kf7ggxZ-ixLO/view

Versioni Anglisht: <https://drive.google.com/file/d/1sjw0Enr1XByd1Jb78RUuqyJYC3L7P9X0/view>

Për më shumë informata kontakto:

kaltrina.kelmendi@unhz.eu